

Deklaratë për Shtyp



BANKA E SHQIPËRISË

Zyra e Shtypit
16 korrik 2009

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2009

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim fiks	R/REPO tremujore
05.01.2009	9,580.00	
08.01.2009	7,560.00	
15.01.2009	5,750.00	
22.01.2009	11,550.00	3,000.00
29.01.2009	6,680.00	2,000.00
05.02.2009	8,730.00	2,000.00
12.02.2009	11,740.00	
19.02.2009	15,400.00	
26.02.2009	14,600.00	
05.03.2009	16,080.00	
12.03.2009	14,210.00	3,000.00
19.03.2009	16,110.00	3,000.00
26.03.2009	11,610.00	
31.03.2009		1,240.00

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për të injektuar likuiditetin, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor* mesatarisht 11.51 miliardë lekë* në javë si dhe instrumentin rregullues me maturim më të gjatë se një javë - *marrëveshjen e riblerjes me maturim 3-mujor*. Instrumenti rregullues u përdor në 6 raste (mesatarisht 2.4 miliardë lekë për ankand), ndërkohë që llogaritur në bazë kumulative, likuiditeti i injektuar nëpërmjet këtij instrumenti në fund të tremujorit të parë, ishte 14.24 miliardë lekë *.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, për investimin e likuiditeteve të lira të krijuara në bazë ditore, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 0.94 miliardë lekë, në krahasim me 2.78 miliardë lekë në tremujorin e kaluar.

Instrumenti i kredisë njëditoresh gjeti përdorim në 8 raste gjatë tremujorit të parë me një mesatare prej 1.55 miliardë lekë për çdo rast përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2009.

*Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale. Shifrat korrespondente në çmim blerjeje që korrespondon me likuiditetin e injektuar janë: injektimi i likuiditetit nëpërmjet instrumentit javor mesatarisht 9.8 miliardë lekë në javë, ndërsa gjendja e likuiditetit të injektuar nëpërmjet instrumentit 3-mujor në fund të tremujorit të parë ishte 12.23 miliardë lekë.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 (me çmim blerjeje).



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, leku ka humbur terren ndaj monedhave të huaja si pasojë e një sërë faktorëve, duke sjellë forcimin e valutave në nivelet më të larta të 4 viteve të fundit. Banka e Shqipërisë me synim shmangien e çrregullime në tregun valutor, ka ndërhyrë gjatë këtij tremujori duke shitur valutë në masën 4,970 milionë lekë.

Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës për llogari të Ministrisë së Financave gjatë tremujorit të dytë arrijnë në nivelin 5,749.80 milionë lekë. Ndërsa, vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave për këtë periudhë ishte 9,994.08 milionë lekë, duke përfshirë edhe blerjet nëpërmjet kontratave të së ardhmes.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 243.58 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA; Fondi Monetar Ndërkombëtar, FMN; dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	9,994.08	5,749.8
TË TJERA (IDA, IBRD)	243.58	
